

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata - Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916739/nafta-ketu-me-shtrenjte-se-ne-europe-bozdo-situata-emergjente-qeveria-te-nderhyje-me-lehtesira-fiskale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:44:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 08:39:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a5a10986e6400971d91b399fc906bd103a32e396ace238578e057756ae154b7
TEKSTI	6cffc11addd93c2466ba7625e7de5accd3fdee1a6e1c72dc029161a6fd7e0ce8
PAMJA	e07ce9968c051f3ca0292619b2029de416c37a51229a2736b2a98753bc8cc5dc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ccfea492a42d8d359f9e89a79486370b61c8d155f8811cf20fd38abe5519809f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	908b1c27d6fb4398f588aae15509a84ac3468307df4d4ded5fae648af40858f1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ccfea492a42d8d359f9e89a79486370b61c8d155f8811cf20fd38abe5519809f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

LAJMI I FUNDIT

Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet Gert 'Gjenerali'

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

10:39, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Partia Demokratike i kërkon me këmbëngulje qeverisë të lehtësojë menjëherë ngarkesën fiskale mbi karburantet. Në një deklaratë për median sot nga selia e Kuvendit, deputeti demokrat Eno Bozdo thekson se situata është emergjente, qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale.

Në veçanti, PD i qëndron propozimit të eliminimit të taksës mbi qarkullimi dhe uljes së përkohëshme të akcizës, kombinim ky që do ta sillte çmimin e dieselit në Shqipëri në mesataren e rajonit.



Arseyeja kryesore sot e çmimeve kaq të larta të dieselit në Shqipëri është ngarkesa shumë e lartë fiskale: shqiptarët paguajnë taksa afërsisht dyfishin e rajonit, dhe nuk marrin në këmbim atë që meritojnë!

Bozdo rikujtoi se çdo iniciativë ligjore e Partisë Demokratike për një propozim të tillë, është rrëzuar me votat e Partisë Socialiste në Kuvend



"Çdo refuzim i mëtejshme i këtyre nismave si dhe çdo këmbëngulje në pozicionin e papërgjegjshmërisë, do të sjellë pasoja shumë të rënda për të gjithë" paralajmëroi Bozdo sot në deklaratën për median nga selia e Kuvendit.

Deklarata për median

Këto ditë, çmimi i dieselit/karburantit në Shqipëri ka arritur nivele rekord, të papërballueshme për ekonominë tonë familjare por edhe atë prodhuese, duke u tregtuar me rreth 229 lekë për Litër, ose ndryshe rreth 2,5 euro për litër.

Kv nivel e vendos Shqipërinë:

Si vendim me çmimin më të lartë të dizelit në rajon, rreth 30% mbi mesataren rajonale;
Mbi mesataren e Bashkimit Evropian, ku çmimi mesatar i dizelit ishte 2 €/L (më 7 shtator 2026)
Mesatarja botërore: 1,4 euro/L
Mesatarja në BE-27: 2,03 €/L
Sipas të dhënave globale (Global Petrol Prices, Fuel Eide), Shqipëria:

është në grupin e 5 vendeve më të shtrenjta në Evropë për dizel, bashkë me Monakon, Finlandën, Gjermaninë, Holandën dhe Danimarkën.
ka çmim dizeli dukshëm mbi mesataren evropiane dhe rreth 55–60% mbi mesataren botërore
Për krahasim, në të njëjtën periudhë çmimet e dizelit në vendet fqinje janë:

Serbi: rreth 2,00 €/L ose 18% më lirë se në Shqipëri;
Kosovë: rreth 1,76 €/L ose 32% më lirë se në Shqipëri;
Maqedoni e Veriut: rreth 1,6 €/L ose 41% më lirë se në Shqipëri;
Mal i Zi: rreth 1,87 €/L ose 20% më lirë se në Shqipëri;
Bosnjë-Hercegovinë: rreth 1,7 €/L ose 27% më lirë se në Shqipëri;

Arsejeja kryesore sot e çmimeve kaq të larta të dizelit në Shqipëri është ngarkesa shumë e lartë fiskale: shqiptarët paguajnë taksa afërsisht dyfishin e rajonit, dhe nuk marrin në këmbim atë që meritojnë!

Në çmimin final të dizelit në Shqipëri, ngarkesa fiskale përbën rreth 53% (afërsisht 1,00–1,16 €/L taksa për litër), përfshirë:

akcizën fikse (~0,41 €/L),

taksën e qarkullimit,

taksën e karbonit, dhe

TVSH-në 20% që aplikohet mbi çmimin total, pra edhe mbi taksat e tjera.

Në vendet e rajonit, barra fiskale mbi dizelin është dukshëm më e ulët, zakonisht rreth 35% e çmimit final. Kjo do të thotë se, për të njëjtin çmim ndërkombëtar të naftës, qytetarët dhe bizneset në Shqipëri paguajnë taksa afërsisht dyfishin e rajonit për litër dizel.

Ajo që e veçon Shqipërinë përsëri, në dallim me vendet e tjera të rajonit dhe të BE-së, është mungesa totale e masave lehtësuese, ndërsa të gjitha vendet e rajonit kanë vepruar me ndërhyrje fiskale lehtësuese:

Serbia ka ulur përkohësisht akcizat mbi benzinën dhe dizelin,
Maqedonia e Veriut ka ulur TVSH-në për karburantet nga 18% në 10%, për të zbutur ndikimin e çmimeve të larta.

Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja kanë përdorur në periudha të mëparshme ulje akcizash dhe kufizime marzhesh, duke mbajtur çmimet më të ulëta se në Shqipëri.

Nuk mund të mos përmendim këtu edhe në argument tjetër: ndërsa çmimet e dizelit rriten, ndërsa qytetarët paguajnë më shtrenjtë nga xhepi i tyre, qeveria fryhet. Nga kriza e mëparshme e naftës, qeveria shqiptare arkëtoi rreth 15 milionë euro më shumë në xhepat e saj, në mënyrë të pamerituar. Asnjë qeveri normale nuk i mban këto para, por gjen mekanizmat për t'ia kthyer ato ekonomisë dhe familjeve. Sepse asnjë qeveri e përgjegjshme nuk pranon të majmet, kur popullata e saj varfërohet!

Të nderuar qytetarë,

Përballë kësaj situatë të paprecedentë, që nuk dihet se si dhe se kur do të zgjidhet, dhe që realisht ka tronditur tregjet në të gjithë vendet, të gjitha qeveritë në botë kanë zgjedhur një apo disa mekanizma lehtësimi të cilat i aplikojnë mbi strukturën/ngarkesën fiskale të çmimit të dizelit, për të lehtësuar, me aq sa kanë mundësi, çmimin e lartë të dizelit i cili, ka ndikim jo vetëm në ekonominë familjare të secilit prej nesh, por mbi të gjitha në ekonominë prodhuese dhe atë të shërbimeve.

Për këtë qëllim, Partia Demokratike i kërkon me këmbëngulje qeverisë të lehtësojë menjëherë ngarkesën fiskale mbi karburantet. Në veçanti, ne i qëndrojmë propozimit tonë të eliminimit të taksës mbi qarkullimi dhe uljes së përkohëshme të akcizës, kombinim ky që do ta sillte çmimin e dizelit në Shqipëri në mesataren e rajonit.

Më duhet të rikujtoj këtu se cdo iniciativë ligjore e Partisë Demokratike për një propozim të tillë, është rrëzuar me votat e Partisë Socialiste në Kuvend!

Cdo refuzim i mëtejshëm i këtyre nismave si dhe cdo këmbëngulje në pozicionin e papërgjegjshmërisë, do të sjellë pasoja shumë të rënda për të gjithë.

një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimi prioritet

SPAK merr nën hetim deputetin e PD, Luan Baçi, Noka: Sulm politik i orkestruar nga mercenarët e narko-rilindjes

Çenon lirinë e medias, Rregullorja e Brendshme e GJKKO-së përfundon në Gjykatë Kushtetuese

Shqiptarja nga Venecia: Rama kriminel! Nuk jemi popull dele, në shesh shoh luanë e luanesha

Lexo edhe:



'Lini Veliain në qeli'! Protestuesi para Gjykatës së Lartë: Në Tiranë paratë u pastruan përmes ndërtimit, me bekimin e tij



'Nëse Veli aj lirohet, loja politike do të përfundojë keq', Gjokutaj: E stisur nga Rama, është tragjikomedi



VIDEO/ 'O gjykatës bëj drejtësi, lër Veli ajn në qeli' / Qytetarët protestojnë para Gjykatës së Lartë

TË NGJASHME



'Balluku negocion me Roni Yeffet për të qëndruar në lojë', Kalaja: Ka në dorë çelësat e qeverisë



'Shqipëria është shitur për interesat e një diktatori të ri', Nesho: Përgjimet e Yeffet, tallje për SHBA



'Pasi ndihmoi Ramën, tani do ndihmojë Putinin' / SPIEGEL: Si po përdoret Kanye West nga Kremli



'Dola thjesht si qytetar', aktivisti Dogjani: Edhe policët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj qeverisë



Konflikti për pagat e gjyqtarëve, ekspertët: Rama do të shpërqendrojë vëmendjen dhe debatin publik nga protestat antiqeveritare



'Saranda po monopolizohet tek të pushtetshmit', Qurku: Po sillen njerëz për ta shkatërruar e kriminalizuar



Mbyllet protesta e 107-të, qytetarët: Rama jepe dorëheqjen

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTE KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.